



Organizata Jo-qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe  
EC MA NDRY SHE

## Sfidat e menaxhimit të hapësirave publike në Prizren

*Janar 2018, Prizren*

### PËRMBAJTJE

I. Hyrje .....	2
II. Korniza ligjore dhe institucionale .....	4
III. Menaxhimi i hapësirave publike në Prizren dhe sfidat .....	5
IV. Rekomandimet .....	10

Ky hulumtim/produkt u realizua në kuadër të projektit “Thellimi i dijes europiane në planifikim dhe zhvillim urban” i përkrahur financiarisht nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur, KFOS. Përmbajtja është përgjegjësi e EC Ma Ndryshe dhe nuk pasqyron doemos pikëpamjet e KFOS-it.

## I. Hyrje

Hulumtimi mbi Menaxhimin e Hapësirave Publike në Prizren trajton sfidat në këtë sferë të qeverisjes lokale. Në këtë dokument janë paraqitur qëndrimet globale lidhur me rëndësinë e Menaxhimit të Hapësirave Publike, pastaj analiza e legjislacionit vendor lidhur me këtë çështje dhe po ashtu shqyrtohen praktikat e deritanishme të Menaxhimit të Hapësirave Publike nga Komuna e Prizrenit, duke sjellë në vëmendje edhe disa shembuj të mirë, ku në sajë të udhëheqjes së ekspertëve janë krijuar hapësira publike të suksesshme. Rekomandimet për Menaxhimin e Hapësirave Publike përfshijnë nevojën për koordinimin e intervenimeve, rregullimin e përdorimit, përcaktimin e rutinave të mirëmbajtjes dhe investimet e shërbimet.

Përkufizimet për hapësirën publike janë të shumta në botën bashkëkohore. Mirëpo emëruesi i përbashkët i tyre është se këto hapësira në rast të planifikimit dhe zbatimit të duhur i bëjnë qytetet më të mira, duke krijuar ambient më të mirë jetësor për komunitetin. Kësisoj ndërveprimi i hapësirës publike me komunitetin është i domosdoshëm dhe politikat publike duhet të hartohen dhe zbatohen mbi këtë parim.

Një përkufizim i paraqitur në uebin e UNESCO-s thekson se “hapësira publike i referohet një zone apo vendi që është e hapur dhe e qasshme për të gjithë njerëzit, pavarësisht gjinisë, racës, etnisë, moshës apo nivelit socio-ekonomik. Këto janë hapësira për tubimin e publikut si sheshet dhe parqet. Hapësirat ndërlidhëse, si trotualet e rrugët, po ashtu janë hapësira publike”. Hapësira publike e dizajnuar dhe mirëmbajtur mirë është qenësore për shëndetin e cilitdo

qytet. Hapësirat e tilla të tubimit mundësojnë përzierjen sociale, pjesëmarrjen qytetare, rekreacionin dhe ndjenjën e përkatësisë.<sup>1</sup>

Sipas UN Habitatit hapësirat publike janë përbërësit vital për qytetet e suksesshme. Ato ndihmojnë në ndërtimin e komunitetit, identitetit qytetar dhe kulturës. Hapësirat publike lehtësojnë kapitalin social, zhvillimin ekonomik dhe rivitalizimin e komunitetit. Përdorimi i vazhdueshëm i hapësirave publike si e mirë publike çon kah mjediset urbane që janë të mirëmbajtura mirë, të shëndetshme dhe të sigurt, duke e bërë qytetin vend atraktiv për jetesë dhe punë.<sup>2</sup>

Gjithnjë sipas UN Habitatit hapësirat publike janë vendet që janë të qasshme dhe të përdorshme nga të gjithë pa motivin e përfitimit dhe paraqiten në forma të ndryshme, përfshirë parqet, rrugët, trotualet, tregjet dhe sheshet e lojërave. Hapësirat e mira publike rrisin kohezionin e komunitetit dhe promovojnë shëndetin, lumturinë dhe mirëqenien për të gjithë qytetarët.<sup>3</sup>

<sup>1</sup> Inclusion Through Access to Public Space, UNESCO, linku: <http://www.unesco.org/new/en/social-and-human-sciences/themes/urban-development/migrants-inclusion-in-cities/good-practices/inclusion-through-access-to-public-space/>, qasur me 30 nëntor 2017

<sup>2</sup> Global Public Space Toolkit: From Global Principles to Local Policies and Practice, 2015, UN Habitat, linku: <https://unhabitat.org/wp-content/uploads/2015/10/Global%20Public%20Space%20Toolkit.pdf>, qasur me 29 nëntor 2017

<sup>3</sup> Global Public Space Programme, UN Habitat, linku: <https://unhabitat.org/urban-initiatives/initiatives-programmes/global-public-space-programme/>, qasur me 30 nëntor 2017

Ndërkaq sipas Habitat III, hapësirat publike janë vendet në pronësi apo shfrytëzim publik, të qasshme dhe të hapura për të gjithë pa motivin e përfitimit, ku përfshihen rrugët, hapësirat e hapura dhe objektet publike.<sup>4</sup>

Në anën tjetër Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal e Republikës së Kosovës thekson se hapësira publike nënkupton hapësirat publike të cilat janë me interes për qytetarët, menaxhohen nga komunat dhe të cilat ndikojnë në cilësinë dhe standardin e jetesës së qytetarëve.<sup>5</sup>

Habitat III konsideron se karakteri i qytetit përcaktohet nga rrugët dhe hapësirat e tij publike, meqë nëse ato dizajnohen dhe mirëmbahen mirë mund të gjenerojnë barazinë, ndikojnë në uljen e nivelit të krimit dhe të dhunës, sjellin vlerë substanciale ekonomike dhe janë qenësore për qëndrueshmërinë e mjedisit. Po ashtu tërheq vëmendjen se sektori privat në përgjithësi dështon në ofrimin e hapësirave publike vërtetë të qasshme, prandaj dhe roli i pushtetit lokal është kritik për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e tyre. Megjithatë në aspektin e menaxhimit dhe mirëmbajtjes autoritetet lokale mund të bashkëpunojnë me qytetarët dhe sektorin privat. Për këtë arsye sugjerohet që hapësirat publike të shihen si hapësira multi-funksionale për ndërveprimin social, shkëmbimin ekonomik dhe shprehjen kulturore në mes të njerëzve të ndryshëm dhe se ato duhet të dizajnohen dhe të menaxhohen

<sup>4</sup> HABITAT III, ISSUE PAPER ON PUBLIC SPACE, linku: [http://habitat3.org/wp-content/uploads/Habitat-III-Issue-Paper-11\\_Public-Space-2.0.compressed.pdf](http://habitat3.org/wp-content/uploads/Habitat-III-Issue-Paper-11_Public-Space-2.0.compressed.pdf), qasur me 1 dhjetor 2017

<sup>5</sup> Raporti i Performancës së Komunave – 2016, MAPL, linku: <http://mapl.rks.gov.net/getattachment/eef640b2-406d-4da3-ac8a-b2383c9d4662/Raporti-i-Performances-se-Komunave-2016.aspx>, qasur me 11 dhjetor 2017

për të siguruar zhvillimin njerëzor, për të ndërtuar shoqëri të qeta dhe demokratike dhe të promovojnë diversitetin kulturor.<sup>6</sup>

Ndërsa në një udhëzues të punuar për Departamentin e Planifikimit të San Franciskos lidhur me hapësirat publike theksohet se hapësirat publike në qytet janë kudo. Më konkretisht, hapësirat publike janë vende ku njerëzit grumbullohen dhe argëtohen, por edhe pushojnë, mësojnë dhe e shprehin vetveten. Këto hapësira kanë ekzistuar përgjatë historisë në të gjitha qytetet dhe kulturat. Por hapësirat publike nuk janë statike. Ato zhvillohen dhe i përgjigjen dinamizmit të jetës së qytetit. Prandaj dizajnimi i tyre duhet ti përshtatet nevojave të komunitetit.<sup>7</sup>

Përfaqësues nga komuniteti i profesionistëve vendorë përshkruajnë se përshtypjet tona për një qytet formohen kryesisht nga cilësia e hapësirave publike, pasi ato duhet të jenë të këndshme, të ruajtura dhe të transmetojnë siguri. Kështu hapësirat publike janë hapësira shoqërore që janë të hapura dhe të qasshme për njerëzit dhe kanë rol të rëndësishëm në jetën shoqërore dhe ekonomike të komunitetit.<sup>8</sup>

<sup>6</sup> HABITAT III, ISSUE PAPER ON PUBLIC SPACE, linku: [http://habitat3.org/wp-content/uploads/Habitat-III-Issue-Paper-11\\_Public-Space-2.0.compressed.pdf](http://habitat3.org/wp-content/uploads/Habitat-III-Issue-Paper-11_Public-Space-2.0.compressed.pdf), qasur me 1 dhjetor 2017

<sup>7</sup> Public Space Stewardship Guide - version 1, San Francisco Planning, linku: [http://publicspacestewardship.org/wp-content/uploads/docs/Task2\\_Mgmt-Guide\\_FINAL\\_WEB.pdf](http://publicspacestewardship.org/wp-content/uploads/docs/Task2_Mgmt-Guide_FINAL_WEB.pdf), qasur me 1 dhjetor 2017

<sup>8</sup> Hapësirat publike në Qendrën Historike të Prizrenit, EC Ma Ndryshe, janar 2018, linku: [http://ecmandryshe.org/repository/docs/180119152\\_201\\_Hulumtimi\\_Hap\\_sirat\\_Publike\\_2017\\_1.pdf](http://ecmandryshe.org/repository/docs/180119152_201_Hulumtimi_Hap_sirat_Publike_2017_1.pdf), qasur me 21 janar 2018

### Korniza ligjore dhe institucionale

Krijimi dhe mirëmbajtja e hapësirave publike sipas legjislacionit në fuqi të Kosovës është përgjegjësi e nivelit lokal të qeverisjes. Një gjë e tillë rregullohet me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, derisa Ligji për Planifikim Hapësinor dhe ai për Mbrojtjen e Mjedisit përmbajnë dispozita për rregullim të qëndrueshëm të hapësirës përkatësisht përmirësimin e kushteve mjedisore.

**Ligji për Vetëqeverisjen Lokale** përkufizon se komunat janë përgjegjëse për planifikimin, investimet dhe mirëmbajtjen e hapësirave publike brenda territorit të tyre. Në nenin 17 që përcakton kompetencat vetanake të Komunave ndër të tjera shkruan se komunat kanë kompetenca për ofrimin dhe mirëmbajtjen e parqeve dhe hapësirës publike.<sup>9</sup>

**Ligji për Planifikimin Hapësinor** ka për qëllim të sigurojë qeverisje të qëndrueshme, shfrytëzim efikas të fondeve publike, parakushte për zhvillim social dhe ekonomik të baraspeshuar, rregullim të qëndrueshëm të hapësirës, duke siguruar trajtim të barabartë, lëvizje të lirë dhe qasje adekuate në shërbimet publike për qytetarët. Sipas këtij ligji planifikimi hapësinor dhe rregullimi duhet të bazohen në parimet e promovimit të interesave të përbashkëta të qytetarëve të Kosovës, duke mbrojtur burimet natyrore, trashëgiminë kulturore dhe përkrahur zhvillim të qëndrueshëm; promovimin e procesit demokratik të pjesëmarrjes publike dhe përfshirjen ndërsektoriale në formulimin e strategjive zhvillimore dhe dokumenteve të

<sup>9</sup> Ligji për Vetëqeverisje Lokale, linku: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530>, qasur me 1 dhjetor 2017

planifikimit hapësinor; promovimin e transparencës së plotë në procesin e planifikimit dhe vendimmarrjes, duke siguruar qasje publike për palët e interesuara, promovimin e cilësisë së lartë të jetesës dhe sistemeve të qëndrueshme për zhvillimin e vendbanimeve, zhvillim të qëndrueshëm dhe proporcional të komunitetit, duke shfrytëzuar në mënyrë efikase fondet publike, etj.<sup>10</sup>

**Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit** synon shfrytëzimin racional të resurseve natyrore dhe kufizimin e ndotjes së mjedisit, parandalimin e dëmtimit, rehabilitimin dhe përmirësimin e mjedisit të dëmtuar, sikurse edhe përmirësimin e kushteve mjedisore, që lidhen me cilësinë e jetës dhe mbrojtjen e shëndetit të njeriut. Ky ligj kërkon ruajtjen dhe mirëmbajtjen e resurseve natyrore, si dhe menaxhimin e qëndrueshëm të tyre.<sup>11</sup>

**Statuti i Komunës së Prizrenit** thekson se Komuna në territorin e saj është përgjegjëse për sigurimin dhe mirëmbajtjen e parqeve publike, hapësirave të hapura dhe varrezave. Po ashtu edhe për lëshimin e lejeve për shërbime dhe pajisje, duke përfshirë argëtimin, shitjet në rrugë, tregjet, panaiet, etj.

**Vendimi i Kuvendit të Komunës së Prizrenit për organizimin e brendshëm, sistematizimin, përshkrimin dhe klasifikimin e vendeve të punës në Administratës e Komunës së Prizrenit** përcakton se **Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor** është përgjegjëse për zhvillimin hapësinor dhe urbanistik të Komunës. Ndër të tjera është kompetente për dhënien e

<sup>10</sup> Ligji për Planifikim Hapësinor, linku: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8865>, qasur me 1 dhjetor 2017

<sup>11</sup> Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit, linku: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2631>, qasur me 1 dhjetor 2017

lejeve për shfrytëzimin e sipërfaqeve publike para lokaleve afariste e hoteliere, si dhe stendave lëvizëse. Ndërsa **Drejtoria e Shërbimeve Publike** ndër të tjera është përgjegjëse për organizimin e mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve dhe pastrimin e rrugëve, trotuareve të qytetit dhe të rrugëve lokale, derisa mbikëqyr edhe mirëmbajtjen e parqeve, hapësirave publike dhe varrezave, funksionimin e tregjeve, etj. Sektori i infrastrukturës në këtë drejtori bën planifikimin e investimeve kapitale. Ndërsa Sektori i Mjedisit është përgjegjës për zgjerimin dhe mirëmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbëruara; planifikimin, ndërtimin e parqeve dhe shesheve të komunës; menaxhimin, kontrollimin dhe pastrimin e të gjitha shesheve që i përkasin komunës; mbikëqyr mirëmbajtjen e pastërtisë së qytetit, etj.<sup>12</sup>

**Rregullorja për tarifën, ngarkesat dhe gjomat nga shërbimet dhe veprimtaritë komunale** parasheh që për shfrytëzimin e përkohshëm të hapësirës publike për kryerjen e veprimtarisë së tyre, subjektet afariste të regjistruara të paguajnë taksën ditore.

Marrë në përgjithësi korniza ligjore dhe institucionale e Republikës së Kosovës dhe e Komunës së Prizrenit për hapësirat publike në përgjithësi i kushton shumë pak vëmendje aspektit të menaxhimit të tyre.

### **Menaxhimi i hapësirave publike në Prizren dhe sfidat**

Në një publikim të UN-Habitatit në Kosovë shkruan se “zakonisht askush në Kosovë nuk kujdeset për hapësirat urbane publike, ato nuk duhen, nuk çmohen dhe nuk shfrytëzohen ose shfrytëzohen pak, dhe zakonisht shihen vetëm si vende për të kaluar nëpër to dhe vlerësohen vetëm si vend parkim joformal për vetura ose diku si vend për hedhjen e mbeturinave”.<sup>13</sup>

Nga e kaluara e afërt ka shembuj të mjaftueshëm në qytetet e Kosovës ku hapësirat publike përballen me praktika të dobëta të menaxhimit dhe mirëmbajtjes. Një gjë e tillë shihet qartë sidomos me rastet e vandalizmave dhe dëmtimit të hapësirave e pajisjeve, gjë që bën që njerëzit e rëndomtë të mos ndihen rehat në këto pjesë. Kjo situatë nuk ndërlihet vetëm me mungesën e burimeve financiare për menaxhimin e tyre por edhe me mungesën e kuptimit të nocionit të hapësirës publike dhe implikimeve që ato kanë për përdoruesit, profesionistët dhe politikbërësit. Prandaj hapësirat publike nuk kanë të bëjnë vetëm me mjedisin fizik, dizajnin dhe mirëmbajtjen e tyre, por duhet të përfshijnë dimensionet e partneritetit, menaxhimit, financimit dhe evaluimit. Në këtë aspekt, as qyteti i Prizrenit nuk bën përjashtim.

Shqetësim i dukshëm mbetet fakti që Kosova radhitet në mesin e vendeve me pak hapësira

<sup>12</sup> Vendimi i Kuvendit të Komunës së Prizrenit për organizimin e brendshëm, sistematizimin, përshkrimin dhe klasifikimin e vendeve të punës në Administratën e Komunës së Prizrenit, i miratuar në KK, më 15 nëntor 2012.

<sup>13</sup> "Shndërrimi i Hapësirave në Vende", publikim nga Programi për Mbështetje të Planifikimit Hapësinor Komunal (MuSPP) i zbatuar nga UN-Habitat në Kosovë, linku: [http://www.unhabitat-kosovo.org/repository/docs/Turning\\_Spaces\\_ALB\\_w eb\\_797319.pdf](http://www.unhabitat-kosovo.org/repository/docs/Turning_Spaces_ALB_w eb_797319.pdf), qasur me 1 dhjetor 2017

të gjelbërta, derisa situata është edhe më e keqe sa i përket shesheve publike.

Analiza e të dhënave nga MAPL në bazë të informatave të marra nga Komunitatet e Kosovës tregon se sipërfaqja e hapësirave të gjelbra publike dhe shesheve publike është në shkallën 4.18 m<sup>2</sup> për kokë banori. Të dhënat e publikuara nga kjo ministri bëjnë të ditur se qytetarët e Kosovës jetojnë në një mjedis me 7.81 m<sup>2</sup> për kokë banori hapësira të gjelbra. Kosova hynë në kuadrin e vendeve me hapësira të gjelbërta në shkallë të ulët. Statistikat botërore tregojnë për një ndryshim të madh prej vendit në vend, por vlerat sillen prej 1.90 (Buenos Aires) deri në 144.59 m<sup>2</sup> për kokë banori, në Edinburg. Sipas MAPL-it, gjendja është shumë më e keqe me sheshet publike, pasi mesatarja e vendit është vetëm 0.54 m<sup>2</sup> për kokë banori. Ndërkaq shkalla e mirëmbajtjes së hapësirave të gjelbra dhe të shesheve, është arritur deri në shkallën 72.07%. Kjo është një arritje e kënaqshme, por shkalla e dokumentimit për këtë tregues është 45.7%, që sipas MAPL na jep të kuptojmë se një pjesë e të dhënave mund të mos jenë plotësisht të sakta. MAPL ka pranuar se dokumentimi i të dhënave nga komunitatet është i pamjaftueshëm dhe se si rrjedhojë edhe besueshmëria e të dhënave është e vogël. Megjithatë në Prizren është raportuar se hapësirat e gjelbra dhe të shesheve janë 4.44m<sup>2</sup>/kokë banori.<sup>14</sup>

Bazuar në raportet e performancave të komunave, në vitin 2014 performanca e komunës së Prizrenit për parqet dhe sheshet ka treguar se sipërfaqja e parkut/sheshit për kokë

banori, në metër katror është 0.12,<sup>15</sup> derisa në vitin 2015 sipërfaqja e parkut/sheshit për kokë banori, në metër katror në Prizren është 0.11.<sup>16</sup>

Në raportin e performancës së komunave të vitit 2016, MAPL ka rekomanduar komunitatet që t'i përcaktojnë qartë hapësirat e gjelbërta dhe sheshet publike në planet e tyre rregulluese komunale dhe ka theksuar se vërehet nevoja e rritjes së kujdesit për këto hapësira më shumë. Ndërsa komuna e Prizrenit është rekomanduar pos tjerash që të punojë më shumë në planifikimin hapësinor dhe në mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbra dhe shesheve dhe krijimin e hapësirave për parkim publik.<sup>17</sup>

Në udhëzuesin e përgatitur nga DEMOS-i mes tjerash theksohet se nga evidentimi paraprak, në përgjithësi, cilësia jo e mirë e mirëmbajtjes së Hapësirave të Hapura Publike në komunitatet e Kosovës vjen si pasojë e mungesës së komponentës së mirëmbajtjes së detajuar me përshkrimin e aktiviteteve të mirëmbajtjes së HHP-ve në fazën e planifikimit (te HHP-të e reja); strukturës së menaxhimit (personelit të limituar të drejtorisë përkatëse), buxhetit; përkrahjes politike; bazës së të dhënave për HHP-të dhe pjesëmarrjes së ultë të

<sup>14</sup> Raporti i Performancës së Komunave për vitin 2016, MAPL, linku: <http://mapl.rks-gov.net/getattachment/eef640b2-406d-4da3-ac8a-b2383c9d4662/Raporti-i-Performances-se-Komunave-2016.aspx>, qasur me 2 dhjetor 2017

<sup>15</sup> Raporti i Performancës së Komunave për vitin 2014, MAPL, linku: <http://mapl.rks-gov.net/getattachment/1cd49ef2-43c0-4933-9f55-c4dc8bea2d9c/Raporti-i-Performances-se-Komunave-2014.aspx>, qasur me 2 dhjetor 2017

<sup>16</sup> Raporti i Performancës së Komunave për vitin 2015, MAPL, linku: <http://mapl.rks-gov.net/getattachment/8d8af839-bdeb-4512-918a-5c337e59fb4f/RAPORTI-I-PERFORMANCES-SE-KOMUNAVE-2015.aspx>, qasur me 2 dhjetor 2017

<sup>17</sup> Raporti i Performancës së Komunave për vitin 2016, MAPL, linku: <http://mapl.rks-gov.net/getattachment/eef640b2-406d-4da3-ac8a-b2383c9d4662/Raporti-i-Performances-se-Komunave-2016.aspx>, qasur me 2 dhjetor 2017

komunitetit gjatë planifikimit dhe monitorimit të shërbimeve.<sup>18</sup>

Ndërkaq zyrtarët komunalë të Prizrenit kanë pranuar se ka sfida të shumta në menaxhimin e hapësirave publike. Sipas tyre Komuna e Prizrenit nuk ka rregullore për menaxhimin e hapësirave publike. Ata kanë pohuar se sektori i mjedisit dhe ai i mbeturinave në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike përkujdesen për mirëmbajtjen dhe pastërtinë e hapësirave publike. Mirëmbajtja e rrugëve, shesheve, trotuareve dhe hapësirave publike të gjelbërta është përgjegjësi e sektorit të mjedisit në DSHP, me ç'rast kjo drejtori ka kontraktuar një ndërmarrje publike dhe dy private për kryerjen e punëve të kësaj natyre.<sup>19</sup> Vlera mujore e këtyre kontratave është raportuar të jetë 72 mijë euro në vitin 2016.<sup>20</sup> Sipas zyrtarëve komunalë janë rreth 20 hektarë hapësira të gjelbra në menaxhim nga kompanitë e kontraktuara. Ata pohojnë se gjendja në hapësirat publike të gjelbërta është më e mirë se në hapësirat publike "inerte". Në të njëjtën kohë kanë konfirmuar se DUPH-ja është kompetente për dhënien e lejeve për shfrytëzimin e sipërfaqeve publike para lokaleve afariste e hoteliere sipas tarifave të përcaktuara në rregulloren përkatëse, derisa DSHP-ja është përgjegjëse për zgjerimin dhe mirëmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbëruara; planifikimin, ndërtimin e parqeve dhe shesheve të komunës;

<sup>18</sup> Hartimi i Planit për Mirëmbajtjen dhe Planit për Invesime në Hapësira të Hapura Publike, Udhëzues për komunat në Kosovë, Helvetas-Swiss Intercooperation Kosovë (HSI-K)/DEMOS, linku: [http://helvetas-ks.org/demos/wp-content/uploads/2017/10/Udhezues-per-hartimin-e-PMHHP-PIHHP\\_01.pdf](http://helvetas-ks.org/demos/wp-content/uploads/2017/10/Udhezues-per-hartimin-e-PMHHP-PIHHP_01.pdf), qasur me 5 dhjetor 2017

<sup>19</sup> Intervistë me zyrtarët e DSHP-së, Komuna Prizren, 15 dhjetor 2017

<sup>20</sup> Raport vjetor, 2016, DSHP e Komunës së Prizrenit, qasur me 7 dhjetor 2017

menaxhimin, kontrollimin dhe pastrimin e të gjitha shesheve që i përkasin komunës dhe se lëshon pëlqime afatshkurtra për shfrytëzimin e përkohshëm të hapësirave publike, pa tarifa. Po ashtu kanë bërë të ditur se disa hapësira të gjelbëra publike (kryesisht rrethrotullime) në zonat e ndryshme të qytetit mirëmbahen në partneritet me bizneset, të cilat nuk i paguajnë qira komunës por e shfrytëzojnë hapësirën për reklamat e tyre. Partneritet sipas tyre pos bizneseve ka edhe me shoqërinë civile dhe akterët tjerë kryesisht në zhvillimin e aktiviteteve mjedisore, me qëllim të ndërgjegjësimit për nevojën e kujdesit ndaj hapësirave të gjelbra publike.<sup>21</sup>

Baza orientuese për planifikimin dhe investimet në hapësirat publike sipas zyrtarëve të DSHP-së është Plani Zhvillimor Komunal, ndërkohë që prioritetet përcaktohen edhe në bazë të nevojave që dalin gjatë punës në baza ditore. Megjithatë ata pranojnë se ka sfida në planifikim, me ç'rast pjesëmarrja e qytetarëve është në nivel të ulët, ndërkohë që për shkak të procedurave të prokurimit dhe nevojës për shfrytëzimin e fondeve në dispozicion nga granti qeveritar kufizohen afatet kohore për Komunën dhe nevojitet veprimi i nxituar në këtë drejtim. Një tjetër sfidë sipas tyre vjen si pasojë e hapësirës së ngushtë në zonën urbane, derisa zona historike paraqitet si çështje komplekse. Mirëpo njëra nga çështjet më shqetësuese në raport me hapësirat publike sipas zyrtarëve të sektorit të mjedisit është mungesa e parkingjeve, që pastaj manifestohet me parkimin e veturave në hapësirat publike si trotualet, mini-zonat e gjelbra, sheshet, etj. Ata pajtohen se këto çështje duhet të zgjidhen me

<sup>21</sup> Intervistë me zyrtarët e DSHP-së, Komuna Prizren, 15 dhjetor 2017

planifikim më të mirë me angazhimin e planerëve urban të mirëfilltë.<sup>22</sup>

Në anën tjetër edhe në hulumtimet e mëparme, EC ka theksuar se bazuar në kuadrin ligjor ekzistues, ndërveprimi me komunitet në proces të planifikimit rregullohet përmes dispozitave që përcaktojnë numrin e diskutimeve publike të fazave të projektit që duhet të kryhen përpara se plani të validohet. Mirëpo, diskutimet publike, në mënyrën se si mbahen në Kosovë, nuk janë aspak formë e bashkëpunimit me komunitet në planifikim të qyteteve. Ato mbahen në forma plenare, ku nga të pranishmit pritet të dëgjohet ndonjë koment i izoluar mbi fazën finale të planit, i cili prezantohet në medime jo fort të kuptueshme për ta. Kështu, nuk mbërrihet as të merret ndonjë kërkesë apo nevojë specifike e komunitetit banues të zonës që planifikohet, por as ndonjë koment substancial rreth planit, i cili prezantohet para publikut. Kësisoj pas marrjes së vizës së mbajtjes së diskutimit publik, planet shkojnë në Kuvend dhe aprovohen. Dhe për pasojë të këtij procesi me të meta, dhe moszbatimit të duhur të kuadrin ligjor dhe mungesës së komunikimit me komunitet, i gjithë mjedisi i ndërtuar mbetet problematik për nga mosfunksionimi i mirë i infrastrukturës, me hapësirë publike jofunksionale, me barriera arkitektonike për komunitet që kanë mobilitet të kufizuar dhe në përgjithësi krijohet më shumë qytet përjashtues sesa gjithëpërfshirës.<sup>23</sup>

Në një anketim, qytetarët e Prizrenit nga lista e pesë çështjeve urbanistike që janë më të

rëndësishme e që duhet të kenë një adresim nga organet komunale, kanë theksuar bllokimin e trotuareve me 21%, problemet e qarkullimit për personat me aftësi të kufizuara me 16%, shkatërrimin e Qendrës Historike me 15%, mungesën e korsive për biçikleta me 16% dhe mungesën e hapësirave të gjelbëruara në qytet me 15%. Të gjitha këto çështje ndërlidhen me nevojën e planifikimit dhe menaxhimit të duhur të hapësirës publike. Ndërsa sa i përket shfrytëzimit të hapësirave publike në lagje qytetarët kanë deklaruar se në 44% të rasteve ata i shfrytëzojnë ato disa herë gjatë muajit, 31% disa herë gjatë javës, 16% e bëjnë këtë për çdo ditë, kurse vetëm 9% nuk i shfrytëzojnë hapësirat publike.<sup>24</sup> Hulumtimet e viteve të kaluara në kuadër të projektit “Qyteti gjithëpërfshirës...”, rregullisht e patën nxjerrë si shqetësim të qytetarëve mungesën e hapësirave gjelbëruese në pjesën urbane.<sup>25</sup>

Në një analizë të bërë nga EC-i del se Qendra Historike e Prizrenit ka gjithsej sipërfaqe prej 62,88 hektarë dhe vetëm 9 për qind e kësaj sipërfaqeje shfrytëzohet si hapësirë publike. Gjithashtu nga matjet e bëra del që rreth 45 për qind e hapësirave publike brenda Qendrës Historike të Prizrenit janë të pashfrytëzuara ose pak të shfrytëzuara derisa të pa qasshme për publik janë 25 për qind e hapësirave publike

<sup>22</sup> Po aty

<sup>23</sup> Raporti i punëtorisë së vizionimit Parku i Qytetit, EC Ma Ndryshe, linku: [http://ecmandryshe.org/repository/docs/161208123218\\_RAPORTI\\_I\\_PUNETORISE\\_SE\\_VIZIONIMIT\\_PARK\\_U\\_I\\_PRIZRENIT\\_RBASHA.pdf](http://ecmandryshe.org/repository/docs/161208123218_RAPORTI_I_PUNETORISE_SE_VIZIONIMIT_PARK_U_I_PRIZRENIT_RBASHA.pdf), qasur me 30 nëntor 2017.

<sup>24</sup> Planifikimi Urban për Qytetarët 5, EC Ma Ndryshe, linku: [http://ecmandryshe.org/repository/docs/170209170458\\_08\\_12\\_2016\\_RBASHA\\_Analiza\\_5\\_Planifikimi\\_Urban\\_per\\_Qytetare\\_Final.pdf](http://ecmandryshe.org/repository/docs/170209170458_08_12_2016_RBASHA_Analiza_5_Planifikimi_Urban_per_Qytetare_Final.pdf), qasur me 3 dhjetor 2017

<sup>25</sup> Komunikatë e EC Ma Ndryshe, linku: [http://ecmandryshe.org/repository/docs/Komunikata-Hapesira\\_te\\_gjelbra\\_12.12.2016-.pdf](http://ecmandryshe.org/repository/docs/Komunikata-Hapesira_te_gjelbra_12.12.2016-.pdf)



dhe 50 për qind janë të qasshme vetëm me përcjellje.<sup>26</sup>

Aktivizmi i deritanishëm i EC-it në këtë drejtim vazhdimisht ka kërkuar më shumë vëmendje dhe kujdes të autoriteteve për krijimin e hapësirave publike gjelbëruese brenda zonës urbane pasi që qytetarët e Prizrenit duhet ta gëzojnë të drejtën për më shumë hapësira dhe vende të gjelbra për tu relaksuar.

EC konsideron se hapësirat e gjelbra, me mundësi për ulje, zhvillim të lojërave dhe leximit e rekreimit, janë disa nga mundësitë që qytetarët ia vlen t'i kenë në qytetin e tyre, prandaj dhe përmes nismave të ndryshme është përpjekur që të nxisë idenë mbi ndryshimin e hapësirës publike, gjithmonë duke e pasur vet qytetarin në fokus. Prandaj Prizreni duhet ta përdorë hapësirën publike në shërbim të fëmijëve, PAK-ve, grave, të moshuarve përkatësisht të gjitha kategorive të shoqërisë. Për këtë arsye në të kaluarën e afërt edhe janë prezantuar vizionimet e realizuara me përfshirjen e komunitetit, si: “Komunë e hapur”, “Hapësira publike në Bazhdarane”, “Hapësira publike në Ortakoll”, “Shtegu për çiklistë”, “Vizioni për bunkerin në Ortakoll”, “Vizioni për rrugën Marin Barleti”, “Vizioni për lagjen "Jeta e Re””, “Keji në shërbim të komunitetit”, “Vizioni për parkun e fshatit Piranë” dhe “Gruaja dhe Hapësira Publike”.<sup>27</sup> Me qëllim të nxitjes së autoriteteve lokale për veprim në këtë drejtim janë realizuar edhe disa performansa publike, si: “Komuniteti i çiklistëve të Prizrenit pedalon

për korsi”, “Të moshuarit e Prizrenit angazhohen për më shumë gjelbërim”, ““Komunë e Hapur II”, thirrja e radhës për rimendimin e hapësirave publike”, “Trotuari nuk është vendparking”, “Prizreni, një qendër e parkingjeve kaotike”, “Më shumë gjelbërim për zonën urbane të Prizrenit”, “Trotuari në shërbim të këmbësorëve dhe komunitetit të lagjes”, “Performanca në lum për më shumë hapësira të gjelbëruara”, etj.<sup>28</sup>

Përfaqësues nga komuniteti i profesionistëve vendor konsiderojnë se hapësirat publike frekuentohen nga shfrytëzues të kategorive të ndryshme të shoqërisë, varësisht nga kërkesat dhe nevojat e tyre ditore. Sipas tyre, qyteti, me theks në hapësirat e përbashkëta, pra ato publike, dallon nga mënyra se si arrin të përmbush kërkesat e shfrytëzuesve varësisht se në cilën kategori bëjnë pjesë ata.<sup>29</sup>

Ndërsa sipas UN Habitatit cilësia e jetës urbane është qenësore për prosperitetin e qyteteve, pasi që qytetet që përmirësojnë cilësinë e jetës për qytetarët e tyre përjetojnë nivele më të larta të prosperitetit dhe kanë më shumë gjasa që të gjejnë veten më të përparuar në pikëpamje të qëndrueshmërisë. Qytetet e tilla orvaten për barazi sociale me rritjen e qasshmërisë në të përbashkëtat urbane dhe të mirën publike, duke parandaluar përvetësimin privat dhe zgjerojnë horizontin për cilësi të përmirësuar të jetës për të gjithë. Qytetet që kanë nocion të fortë të “publikes” demonstrojnë përkushtimin për cilësi të përmirësuar të jetë për qytetarët e tyre duke

<sup>26</sup> Hapësirat publike në Qendrën Historike të Prizrenit, EC Ma Ndryshe, janar 2018, linku: [http://ecmandryshe.org/repository/docs/180119152\\_201\\_Hulumtimi\\_Hap\\_sirat\\_Publike\\_2017\\_1.pdf](http://ecmandryshe.org/repository/docs/180119152_201_Hulumtimi_Hap_sirat_Publike_2017_1.pdf), qasur me 21 janar 2018

<sup>27</sup> Hollësitë lidhur me këto vizionime mund të gjenden në linkun: <http://mahalla.info/sq/vizioni-per-lagjen>

<sup>28</sup> Hollësitë lidhur me këto performanca publike mund të gjenden në ueb faqen e EC Ma Ndryshe

<sup>29</sup> Gruaja dhe Hapësira Publike, EC Ma Ndryshe, linku: [http://ecmandryshe.org/repository/docs/170929112\\_136\\_SIGURIA\\_E\\_HAPESIRAVE\\_PUBLIKE\\_compressed.pdf](http://ecmandryshe.org/repository/docs/170929112_136_SIGURIA_E_HAPESIRAVE_PUBLIKE_compressed.pdf), qasur me 7 dhjetor 2017

ofruar hapësirë rrugore, hapësira të gjelbra, parqe, hapësira rekreative dhe hapësira tjera publike.

Siç u tha edhe në pjesën hyrëse të këtij hulumtimi hapësirat publike janë përbërësit vital për qytetet e suksesshme. Ato ndihmojnë në ndërtimin e komunitetit, identitetit qytetar dhe kulturës. Hapësirat publike lehtësojnë kapitalin social, zhvillimin ekonomik dhe rivitalizimin e komunitetit. Përdorimi i vazhdueshëm i hapësirave publike si e mirë publike çon kah mjediset urbane që janë të mirëmbajtura mirë, të shëndetshme dhe të sigurta, duke e bërë qytetin vend atraktiv për jetesë dhe punë.<sup>30</sup>

Për arsyet e lartcekura Komuna e Prizrenit duhet të rishikojë politikat e deritanishme në raport me krijimin dhe menaxhimin e hapësirave publike me qëllim të përqafimit të praktikave më të mira botërore në këtë drejtim.

### Rekomandimet

Menaxhimi i Hapësirave Publike përfshinë nevojën për koordinimin e intervenimeve në këto hapësira, rregullimin e përdorimit të tyre, pastaj përcaktimin e rutinave të mirëmbajtjes dhe definimin e investimeve e shërbimeve. Prandaj Komuna e Prizrenit duhet të reformojë dhe fuqizojë strukturën menaxhuese brenda drejtorive të saj për realizimin e këtyre objektivave, duke punuar drejt formimit të sektorit për menaxhimin e hapësirave publike, i cili do të koordinonte veprimtarinë me drejtoritë që kanë përgjegjësi në këtë drejtim;

Menaxhimi i Hapësirave Publike përkatësisht koordinimi i intervenimeve, rregullimi i përdorimit të tyre, përcaktimi i rutinave të mirëmbajtjes dhe definimi i investimeve e shërbimeve mund të formalizohet brenda administratës komunale me miratimin e një akti komunal (rregullore apo udhëzues);

Komuna e Prizrenit duhet të aplikojë praktika të mira të menaxhimit të hapësirave publike, duke marrë parasysh rolin e institucioneve shtetërore, sektorit privat dhe shoqërisë civile respektivisht komunitetit;

Komuna e Prizrenit duhet të përkrah edhe nismat e komunitetit, që kanë vetiniciativë për rregullimin dhe menaxhimin e hapësirës publike në mjedisin ku jetojnë;

Komuna e Prizrenit, si autoritet vendimmarrës për krijim të kushteve dhe mirëmbajtje të hapësirave publike duhet të adoptojë qasje gjithëpërfshirëse në planifikim, trajtim dhe në përshtatje të hapësirave publike për nevojat e komunitetit;

Komuna e Prizrenit duhet të aplikojë konkurs publik dhe qasje gjithëpërfshirëse në krijim të hapësirave të reja;

Planet Rregulluese të Hollësishme duhet të kenë përqendrim të qartë të hapësirat publike

dhe

Dizajnimi i hapësirave publike duhet të jetë i orientuar kah mirëmbajtja e mundshme dhe me qasje për të gjitha grupet e komunitetit.

<sup>30</sup> "Global Public Space Toolkit: From Global Principles to Local Policies and Practice", UN Habitat, linku: <https://unhabitat.org/wp-content/uploads/2015/10/Global%20Public%20Space%20Toolkit.pdf>, qasur me 3 dhjetor 2017.